

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BE-ja zgjat afatin e sanksioneve ndaj Rusisë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/be-ja-zgjat-afatin-e-sanksioneve-ndaj-rusise/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 06:46:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 06:42:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6a1c060c6741dcf36c42dc09811351057636d7248fb83e084190f48f5af60ed6
TEKSTI	970b690e6a1cbf36de4816421b25245bb52f635ff80d1f7599603c40a49e8540
PAMJA	8b9cffa78917ecf408835280e3547804a0a62cf0ba2d61a911b9a96c1ebd1372

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	429492ba955418cee49c945815d338fded5268fa683af60c1999ef57945f262e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/429492ba955418cee49c945815d338fded5268fa683af60c1999ef57945f262e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Donald Trump Erion Veliaj Bekim Sejdiu BE

BOTA

BE-ja zgjat afatin e sanksioneve ndaj Rusisë

15 Shtator 2026 | 08:42

Lista e zezë e Bashkimit Evropian me pothuajse 3,000 individë dhe subjekte, e cila duhet të zgjatet çdo gjashtë muaj, do të skadonte të mërkurën.

Por ambasadorët nga 27 shtetet anëtare të BE-së e shtynë afatin një javë pasi përpjekjet e vona nga Parisi për të larguar manjatin 73-vjeçar të metaleve uzbek-rus Usmanov hasën kundërshtime.

Usmanov, një ish-aksionar kryesor në klubin e futbollit Arsenal, u vendos në listën e sanksioneve të BE-së në vitin 2022 për atë që Brukseli tha se ishin lidhjet e tij të ngushta me Kremlinin.

"Konsultimet do të vazhdojnë dhe pritet të zhvillohen diskutime të mëtejshme", tha një zëdhënës i Irlandës, e cila mban presidencën e radhës të BE-së.

"Rinovimi i listave është thelbësor për të vazhduar minimin e makinës së luftës së Rusisë dhe për të vazhduar presionin mbi individët dhe subjektet që e mbështesin, e mundësojnë dhe përfitojnë prej saj", tha zëdhënësi.

Diplomatët e BE-së thanë se Franca i zuri në befasi homologët e saj duke mbështetur një kërkesë sllovaqe për ta hequr Usmanovin nga lista. Diplomatët thanë se Franca nuk dha një arsye të qartë përveçse tha se ishte për "siguri kombëtare".

Zyrtarët francezë konfirmuan se po kërkonin të largonin Usmanovin, por nuk dhanë detaje për motivet e tyre.

Financial Times raportoi se Parisi po bënte këtë përpjekje si pjesë e një marrëveshjeje për lirim të burgosurve që përfshinte disa qytetarë francezë të mbajtur në Azerbajxhan, duke cituar njerëz të njohur me çështjen.

Ministri i Jashtëm francez, Jean-Noel Barrot, i tha AFP-së të hënën vetëm se "diskutimet janë duke u zhvilluar në nivel teknik në Bruksel" dhe ai pret që ato të përfundojnë së shpejti.

Diplomatë nga shumë vende të BE-së thanë se kishte një ngurrim të përhapur që blloku të shihej sikur po dobësonte sanksionet e tij ndaj Moskës.

LAJMI I FUNDIT

08:35 Tensionet tregtare me SHBA-në, hyjnë në fuqi tarifat 50% për 110 produkte kanadeze

08:34 Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa dhe dronë

08:28 Trump njoftoi marrëveshjen për mbrojtjen e energjisë, Zelensky: Ukraina është gati të ulë tensionet nëse Rusia bën të njëjtën gjë

08:26 SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN Lagarde ngre alarmin për varësinë teknologjike: Europa duhet të zhvillojë AI-në e saj

08:19 Pas vendimit të Kushtetueses, Gjykata e Lartë shqyrton sot masën e sigurisë për Erion Veliajn

08:13 Incident në hapësirën ajrore baltike, një avion luftarak i NATO-s rrëzon një dron në Lituanë

TESTIM

Vendet e BE-së kishin kërkuar në vend të kësaj zgjatjen e sanksioneve nga gjashtë muaj në një vit, ndërsa kërkojnë të ushtrojnë presion mbi Moskën.

Sanksionet e BE-së përfshijnë figura kyçe, përfshirë presidentin rus Vladimir Putin dhe ministrin e jashtëm Sergei Lavrov.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, në fjalimin e tij të përditshëm, tha: “Absolutisht nuk është koha për të hequr sanksionet”.

“Absolutisht nuk është koha për të shpëtuar oligarkët rusë nga sanksionet. Dhe absolutisht nuk është koha që Evropa t’i bëjë dhurata Ruisë”, shtoi ai.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Tensionet tregtare me SHBA-në, hyjnë në fuqi tarifat 50% për 110 produkte kanadeze

Një raund i ri tarifash amerikane mbi mallrat kanadeze hyri në fuqi pas mesnatës të së martës, duke vendosur taksa prej 50% mbi 110 produkte....

08:35 | 15/09/2026

BOTA

Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa dhe dronë

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralelisht po forcojnë pozicionet e tyre përgjatë...

08:34 | 15/09/2026

BOTA

Trump njoftoi marrëveshjen për mbrojtjen e energjisë, Zelensky: Ukraina është gati të ulë tensionet nëse Rusia bën të njëjtën gjë

Presidenti Volodymyr Zelensky tha se Ukraina ishte gati të ulte tensionet në luftë me Rusinë nëse rivali i saj bënte të njëjtën gjë, pasi Presidenti...

08:28 | 15/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: